



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLES SE PARE**  
**PER KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**  
**2024**

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
1.	03.01.2024	Kerkese per informacion KLGJ-shkrese përcjellëse per informacion me kërkues Armand Kullua mbi numrin e çështjeve te shortuara manualisht per periudhën 2018 deri ne dhjetor 2023	10.01.2024	Ish Gjykata e Shkalles se pare per krime te Renda, per vitin kalendarik 2018, 2019 nuk ka shortuar asnjë çështje me short manual. GJKKO, per vitin kalendarik 2020 ka hedhur short manual vetëm ne 3 data, per shkak te mungesës se specialistit te IT dhe personelit te gjykatës, si pasoje e periudhës se COVID-19.	Perfunduar	Nuk ka

2.	15.01.2024	Kërkesë për bashkëpunim në lidhje me zbatimin e projektit të financuar nga BE: "Ndërtimi i partneritetit në Kryesoret, fuqizimi i shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në BE" QENDRA PER TRANSPARENCE DHE INFORMIM TE LIRE Sami Nezaj qTIL, drejtor ekzekutiv	24.01.2024	GjKKO duke falënderuar dhe uruar suksese, cakton nje date takimi.	Perfunduar	Nuk ka
3.	14.02.2024	Vendime penale ndaj shtetasit Altin Çoku Klodiana Lala, gazetare News 24	19.02.2024	2 Vendime penale ndaj shtetasit Altin Coku	Perfunduar	Nuk ka
4.	16.02.2024	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, kopje vendimesh te marra nga GJKKO Gazetari Birn				
5.	26.02.2024	Gazetari Elton Qyno, kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentet zyrtare, lidhur me një vendim të ndërmjetëm të marrë nga Gjyqtari i Krimeve të	29.02.2024	Në vijim të shqyrtimit të kërkesën tuaj ku kërkoni vendimin e ndërmjetëm lidhur me ndalimin e publikimit të dëshmisë së	Perfunduar	Nuk ka

		<p>Rënda, Guri Brahimllari, në vitin 2008 ose 2007 në çështjen për gjykim kundër Lulzim Berisha e të tjerë personave.</p>		<p>bashkëpunëtorit të drejtësisë Adriatik Coli, të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ju bëjmë me dije se kjo dosje nuk ndodhet në arkivën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo për faktin, pasi me shkresën Nr. 171 Prot., datë 27.12.2021 të kësaj Gjykate të gjitha dosjet që lidhen me çështjen e mësipërme janë përcjellë për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.</p> <p>Ndodhur në këto kushte, jeni i lutur t'i drejtoheni Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për të marrë</p>	
--	--	---	--	---	--

				<p>informacionin që kërkoni.</p> <p>Bashkëlidhur, gjeni shkresën zyrtare Nr. 171 Prot, datë 27.12.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.</p>		
6.	06.03.2024	<p>Unë Besmir Pula, gazetar i MCN TV, te dhëna/statistika ne lidhje me:</p> <p>1. Sa pasuri të paluajtshme janë sekuestruar nga SPAK gjatë vitit 2023 dhe sa është vlera totale e tyre?</p> <p>2. Sa automjete janë sekuestruar nga SPAK dhe sa është vlera e tyre ne total?</p> <p>3. Kryesisht nga çfarë aktiviteti të paligshëm janë përfituar këto pasuri, dhe pas sekuestrimit përfundimtar ku dorëzohen këtë pasuri?</p>	06.03.2024	<p>Kerkesa u regjistrua dhe bashkëlidhur Analiza vjetore 2023 e GJKKO me te gjitha te dhënat e kërkuara.</p>	Perfunduar	Nuk ka

6.	07.03.2024	<p>Qendra per Studimin e Demokracise dhe Qeverisjes (CSDG)  Arjan Dymishi, Drejtor Ekzekutiv</p> <p>Kerkese per Dokumentacion te vendimeve per çështje te korrupsionit dhe krimin te organizuar per vitin 2022 dhe 2023</p> <p>Kopje te Vendimeve te GJKKO-se per 2022  Kopje te vendimeve te GJKKO-se per 2023</p>				
7.	08.03.2024	<p>Qeleshi and Associate Studio Ligjore</p> <p>Kerkese per Informacion ne lidhje me statistika</p>	21.03.2024	<p>Ne adresën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar datë 08. 03.2024, ka mbërritur "Shkresa", e dërguar prej jush, ku kërkoni të dhëna në lidhje me vendimet e marra nga GJKKO (numrin e kërkesave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.</p>	Perfunduar	Nuk Ka

				<p>Pas verifikimeve të kryera në Kryesekretarinë e GJKKO-së, rezulton se janë gjithsej 15 vendime të marra nga GJKKO, në lidhje me pranimin apo rrëzimin e kërkesave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në 14 vendime, kërkesat e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme janë pranuar, ndërsa vetëm 1 vendim është rrëzuar kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme.</p>		
8.	11.03.2024	Muhamed Veliu, gazetar i Top Channel Kerkese per vënie ne dispozicion te Vendimit Nr. 330, date 23.09.2020.	12.03.2024	Vendimi Nr. 330, eshte me Ekzekutim letër Porosi dhe rrjedhimisht refuzohet kërkesa per marrjen e vendimit, pasi eshte çështje nen	Perfunduar	Nuk Ka

				hetim dhe ka sekrete hetimore.		
9.	27.03.2024	Anila Hoxha Gazetare e Top Channel	16.04.2024	Kërkesë për vendimin e zbardhur ndaj shtetasit Safet Gjici etj 2) Vendimet për pastrim parash nga viti 2022-2023-2024 përfshi dhe ato të miratuara nga gjykata mbasi SPAK e ka pushuar/ mosfilluar procedimin?	Përfunduar zyrtarisht vendimi i skanuar, marrë me usb.	Nuk ka
10.	16.04.2024	Armand Bajrami Gazetar A2CNN	16.04.2024	Kërkesë për kopje të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë të çështjes me të pandehur Dhionis Alfred Beleri dhe Pandeli Kolaveshi.	Përfunduar zyrtarisht vendimi i skanuar, marrë me usb.	Nuk ka
11.	08.04.2024	Top News Gazetare Alketa Shaba	23.04.2024	Statistika të vitit 2023 sa i përket masave të sigurisë që ka kërkuar SPAK ndaj personave nën hetim dhe masat që ka vendosur GJKKO ndaj këtyre personave. Konkretisht, kërkoj të më vihet në dispozicion	Perfunduar dhe kthim përgjigje me te gjitha statistikat e kerkuara	Nuk ka

				numri i masave të sigurisë “arrest në burg”, “arrest në shtëpi” dhe “detyrim paraqitje” të cilat SPAK i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme Anti-korrupsion dhe rastet me shifra kur GJKKO ka vendosur një tjetër masë nga ajo që ka kërkuar SPAK.		
12.	23.04.2024	Top Channel  Gazetare Anila Hoxha		Referuar ligjit për të drejtën e informimit jeni të lutur të vendosni në dispozicion vendimin për shtetasin Adedin Rexha denuar nga ish Gjykata Kunder Krimeve të Rënda.		
13.	23.07.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të Vendimit Nr.45, datë 06.06.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.	23.07.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 13, datë 23.07.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka



				<p>Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është dhënë vendimi penal me nr.45, datë 06.06.2019, në ngarkim të të pandehurit F.D, i deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal. Bashkëlidhur këtij emaili po ju dërgojmë vendimin e sipërcituar në rrugë elektronike.</p> <p>Ju sjellim në vëmendje se, në referim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, konkretisht të: Nenit 2, i cili parashikon se: “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>drejtën e ruajtjes së jetës private.”;</p> <p>Nenit 3 pika 2, i cili përkufizon se: “Të dhëna sensitive është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.”;</p> <p>Nenit 11, i cili parashikon se: “Përpunimi i të dhënave personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike përjashtohet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes”;</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				të ruhet konfidencialiteti i të dhënave të viktimave të veprës penale.		
14.	26.07.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të Vendimit Nr.68, datë 14.12.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.	26.07.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 14, datë 26.07.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është shqyrtuar në seancë gjyqësore, me dyer të mbyllura, çështja penale me nr.regj.themeltar 94, datë rregjistrimi 17.05.2022, në ngarkim të të pandehurit B.P, i cili me vendimin nr.68, datë 14.12.2022 të kësaj gjykate është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të	Përfunduar; Refuzuar (E-mail)	Nuk ka

				<p>shpallur” dhe “Organizata terroriste”, parashikuar nga nenet 230/ç dhe 234/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal.</p> <p>Në seancën gjyqësore të datës 28.09.2022, prokurori ka kërkuar zhvillimin e seancës gjyqësore me dyer të mbyllura për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Po në këtë seancë gjyqësore, gjykata me vendimin të ndërmjetëm, bazuar në nenin 340/1/a të K.Pr.Penale, ka vendosur vijimin e gjykimit me dyer të mbyllura.</p> <p>Në këto kushte, në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), i cili parashikon se: “2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:...</p> <p>b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.”; si dhe nenit 103, pika 1, 2 dhe 3 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “ 1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv; 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake; 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.”, duke qenë se mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, përbën veprë penale sipas nenit 295/a të Kodit Penal nën titullin “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, konstatohet se kërkesa tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin penal të dhënë në ngarkim të shtetasit B.P nuk mund të pranohet. Sa më sipër, refuzohet kërkesën tuaj për t’ju vënë në dispozicion vendimin nr.68, datë 14.12.2022, në ngarkim të shtetasit B.P.</p>		
15.	04.09.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore të	06.09.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim drejtuar Gjykatës së	Përfunduar; Deleguar pranë SPAK kërkesa për informacion	Nuk ka

		<p>formës së prerë në lidhje me veprat penale “<i>Trafikimi i personave të rritur</i>”, “<i>Trafikimi i të miturve</i>”, “<i>Shfrytëzimi i prostitucionit</i>”, parashikuar në nenet 110/a, 114 dhe 128/b të Kodit Penal, kur këto vepra janë kryer nga grupe të strukturuar kriminale, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda të armatosura, sipas përcaktimeve të Kodit Penal, për periudhën 2021-2023 të ndara sipas viteve, si dhe kërkohet informacion në sa prej rasteve është vendosur pranimi i fajësisë. Kërkesë për informacion lidhur me numrin e procedimeve të rregjistruara në gjykatë për çështjet me objektin e sipërcituar, të ndarë sipas objektit dhe sipas viteve.</p>		<p>Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të protokolluar pranë kësaj gjykate me Nr.2992 Prot., datë 05.08.2024, ju bëj me dije si më poshtë: Së pari, kërkesa juaj për informim është rregjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me datë 04.09.2024, me numër rendor 15, për shkak se stafi administrativ i gjykatës ka qenë me leje vjetore sipas parashikimeve të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “<i>Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë</i>”, i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.732, datë 13.11.2019 “<i>Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e</i></p>	<p>lidhur me numrin e procedimeve të rregjistruara. (E-mail)</p>	
--	--	---	--	--	--	--

				<p><i>shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë”.</i></p> <p>Së dyti, pas verifikimeve të bëra si në sistemin elektronik të regjistrimit të çështjeve të kësaj Gjykate, po ashtu dhe në Kryesekretarinë e Gjykatës, rezulton se për periudhën kohore 2021-2023, nga kjo gjykatë nuk është dhënë asnjë vendim penal në lidhje me veprat penale “<i>Trafikimi i personave të rritur</i>”, “<i>Trafikimi i të miturve</i>”, “<i>Shfrytëzimi i prositucionit</i>”, të parashikuara nga nenet 110/a, 128/b dhe 114 të Kodit Penal, të kryera si vepra penale në kuadër të grupit strukturuar kriminal, organizatës kriminale, apo organizatës terroriste dhe bandës së armatosur, parashikuar nga nenet</p>	
--	--	--	--	--	--



				<p>333/a, 333, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal.</p> <p>Së treti, sa i përket kërkesës për informacion lidhur me numrin e procedimeve të regjistruara në gjykatë për çështjet që kanë për objekt veprat penale të sipërcituara, ju informojmë se regjistrimi i një procedimi penal nuk është kompetencë e gjykatës dhe kjo gjykatë nuk e disponon një informacion të tillë. Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë procedimet penale regjistrohen nga organi i prokurorisë.</p> <p>Në këto kushte, në referim të nenit 12, pika 2 të ligjit nr.119/2014, <i>“Për të drejtën e informimit”</i>, i ndryshuar, i cili parashikon se: <i>“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e</i></p>	
--	--	--	--	--	--

			<p><i>zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyerja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar”, kërkesa juaj për informim lidhur me këtë pjesë i ka kaluar ditën e sotme autoritetit publik kompetent, konkretisht Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.</i></p> <p><i>Në zbatim të nenit 12, pika 3 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, po ju dërgojmë dhe kontaktin zyrtar elektronik (email-in) të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin</i></p>		
--	--	--	--	--	--

				të Organizuar: <a href="mailto:Info@spak.gov.al">Info@spak.gov.al</a>		
16.	06.09.2024	<p>Kërkesë për informacion:</p> <p><b>1.</b> A kanë gjykatat e të gjitha niveleve një zë në buxhet për të paguar përkthyesit e gjuhës së huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave dhe sa ka qenë ky zë për secilin nga 5 vitet e fundit?</p> <p><b>2.</b> Sa është buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të huaja, në procesin penal, në 5 vitet e fundit, nga gjykatat e të gjitha niveleve për secilin vit?</p> <p><b>3.</b> Sa është buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhës së shenjave, në procesin penal, në 5 vitet e fundit, nga gjykatat e të gjitha niveleve për secilin vit?</p> <p><b>4.</b> Sa procese penale me të pandehur me persona me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe të folur ka pasur në gjykatat e të gjitha niveleve në 5 vitet e fundit, për secilin vit?</p>	12.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, përcjellë për kompetencë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën Nr.4160/2 Prot., datë 03.09.2024, protokolluar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Nr.3134 Prot., datë 06.09.2024 dhe regjistruar me numër rendor 16, datë 06.09.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve të kësaj gjykate, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju dërgojmë përgjigjet e pyetjeve si më poshtë vijon:</p> <p><b>1.</b> Po, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjatë detajimit të buxhetit në fillim të vitit, planifikon</p>	Përfunduar (E-mail)	Nuk ka

		<p><b>5.</b> Me çfarë procedure dhe nga kush realizohet përzgjedhja dhe kontaktimi i përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe të gjuhës së shenjave, për një proces penal?</p> <p><b>6.</b> Si llogaritet pagesa që përfiton një përkthyes zyrtar i gjuhës së huaj dhe gjuhës së shenjave për procesin penal dhe me çfarë procedure dhe afatesh kohore realizohet kjo pagesë?</p> <p><b>7.</b> Si ka funksionuar përkthimi në procesin penal i personave që nuk dëgjojnë përpara çertifikimit të interpretëve të gjuhës së shenjave nga Ministria e Drejtësisë.</p> <p><b>8.</b> A janë gjykatat e të gjitha niveleve përgjegjëse për të paguar përkthyesit e gjuhëve të huaja dhe interpretët zyrtarë të gjuhës së shenjave për shërbimet që ata kryejnë në strukturat e policisë dhe prokurorisë për shtetasit e huaj dhe personat që nuk dëgjojnë?</p>		<p>një zë të veçantë për shpenzime për përkthyesit zyrtarë të gjuhës së huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave. Sipas pasqyrës së fondeve buxhetore të planifikuara dhe të realizuara në zërin “Shpenzime përkthimi”, për vitin 2024 ky zë është planifikuar në vlerën 100,000 lekë; për vitin 2023 në vlerën 370.000 lekë; për vitin 2022 në vlerën 59.800 lekë; për vitet 2021 dhe 2020 në vlerën 0 lekë.</p> <p><b>2.</b> dhe <b>3.</b> Zëri i planifikuar në buxhetin vjetor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është një i vetëm si për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të huaja ashtu dhe për interpretët e gjuhës së shenjave, “Shpenzime përkthimi”, pa i detajuar në mënyrë specifike.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		<p><b>9.</b> Sa refuzime ka pasur këto 5 vitet e fundit nga përkthyesit zyrtarë të çertifikuar nga Ministria e Drejtësisë për të marrë pjesë në një proces penal dhe cilat kanë qenë arsyet e këtyre refuzimeve?</p> <p><b>10.</b> Sa raste të mos pagesës së përkthyesve të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave nga gjykatat e të gjitha niveleve ka pasur këto 5 vitet e fundit, për secilin vit dhe pse?</p>		<p>Sipas pasqyrës së fondeve buxhetore të planifikuara dhe të realizuara në zërin “Shpenzime përkthimi”, rezulton se për vitin 2024 buxheti i përdorur për përkthyesit zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe për interpretët e gjuhës së shenjave deri më tani është në vlerën 0 lekë; për vitin 2023 është në vlerën 208.574 lekë; për vitin 2022 është në vlerën 54.296 lekë; për vitet 2021 dhe 2020 është në vlerën 0 lekë.</p> <p><b>4.</b> Lidhur me këtë pyetje, ju informojmë se e dhëna që kërkohet nga ana juaj, nuk është një e dhënë e cila pasqyrohet në rregjistrat fizikë apo elektronikë të kësaj gjykate, për këtë arsye jemi në pamundësi për t’jua vënë në dispozicion këtë informacion.</p> <p><b>5.</b> Në kushtet kur, për zhvillim e një procesi të rregullt ligjor, nevojitet</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>prania e përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave në seancë gjyqësore, kryesuesi i seancës me vendim të ndërmjetëm cakton përkthyesit zyrtar të gjuhës së huaj apo interpretët e gjuhës së shenjave, duke i përzgjedhur ato nga lista e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Kontaktimi i përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave realizohet me fletëthirrje nga ana e ftuesit të gjykatës.</p> <p><b>6.</b> Për përlogaritjen e pagesave për përkthyesit zyrtar të gjuhës së huaj dhe interpretët e gjuhës së shenjave në procesin penal, gjykata zbaton Ligjin Nr.81/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” si dhe Udhëzimin e Përbashkët Nr.8, datë</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>19.07.2022 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”. Sa i përket procedurave dhe afateve kohore të realizimit të pagesave për përkthyesit zyrtar të gjuhëve të huaja dhe interpretët e gjuhës së shenjave, ju informojmë se nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar këto pagesa kryhen në mënyrë të menjëhershme nga momenti i lindjes së detyrimit.</p> <p><b>7.</b> Për përgjigjen e kësaj pyetje ju lutem referohuni në aktet</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë qenë në fuqi përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.81/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”.</p> <p><b>8.</b> Jo, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është përgjegjëse për pagesat e përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave vetëm për shërbimet që ata kryejnë në proceset gjyqësore që zhvillohen në këtë gjykatë.</p> <p><b>9.</b> Lidhur me këtë pyetje, ju informojmë se të dhënat që kërkohen nga ana juaj, nuk janë të dhëna të cilat pasqyrohen në rregjistrat fizikë apo elektronikë të kësaj gjykate, për këtë arsye jemi në pamundësi për t’jua vënë në dispozicion këtë informacion.</p>	
--	--	--	--	---	--



				<p><b>10.</b> Nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ju informojmë se në 5 vitet e fundit nuk ka pasur asnjë rast të mos pagesës së përkthyesve zyrtarë të gjuhëve të huaja dhe interpretëve të gjuhës së shenjave.</p>		
17.	09.09.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit Nr.18, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.</p>	10.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 17, datë 09.09.2024 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, po ju vendosim në dispozicion një kopje fizike të vendimit nr.18, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Konfiskimin e pasurive të shtetasve K.B dhe B.B”.</p>	<p>Përfunduar (Dhënë kopje fizike)</p>	Nuk ka

				<p>Ju sjellim në vëmendje respektimin e dispozitave ligjore të parashikuara nga Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe Udhëzimin Nr.9, datë 15.09.2010 të Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audio vizive”.</p>		
--	--	--	--	---	--	--